

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-052/14

Prishtinë,

20 Korrik 2016

Në çështjen juridike të

L.P.

Omladinskih Brigada 158/21

Beograd, Serbi

Paraqitësi i kërkesës/ Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, Antarë, duke vendosur për ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 56743), i datës 11 Qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur me 20 Korrik 2016, morri këtë

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e pa afatshme ankesa e L.P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/207/2013 për sa i përket lëndës të regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave, me numrin KPA56743.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 13 Mars 2007 L.P. (më tej paraqitësi i ankesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e një objekti montazh për banim dhe tokës në sipërfaqe prej prej 3 ari e 40 metrash katror, që ndodhet në rrugën “JNA”Nr. 38 ngastra kadastrale 2609/1, zona kadastrale Pejë. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se është shfrytëzues i tokës publike dhe pronar i objektit që tani është uzurpuar. Ai ka pretenduar se babai i tij K.P. tani i ndjerë e ka fituar të drejtën pronësore me ndërtim me leje në tokë shoqërore të dhënë për shfrytëzim të përkohshëm. Ai ka kërkuar kthimin në posedim të kesaj prone.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur keto dokumente:
 - Letërnjoftim lëshuar nga organet Republikës së Serbisë me 18.02.2005;
 - Vendim Br. 05-351/1847 datë 30 Shtator 1993 të marrë nga Komuna e Pejës njesia për urbanizëm, çështje banesore dhe pronësore-juridike. Vendimi i ka lejuar paraqitësit të kërkesës që të shfrytëzoje përkohësisht tokën shoqërore me afta prej 6 muajsh.
 - Kushtet urbano-teknike të rregullimit të tokës për ndërtimin e obketit .
 - Certifikatë vdekje e lëshuar nga uatoritetet e Serbisë që deshmon se K.P. ka vdekur me 1 Gusht 2000.
 - Letërnjoftim i lëshuar me 2 Tetor 2002 lëshuar nga autoritetet e Serbise
3. AKP-ja e ka publikuar kërkesën sipas procedurës standarde duke vendosur një njoftimin në pronë me 14 Tetor 2008. Me 26 Mars 2013 është konstatuar se identifikimi i pronës është bërë në mënyrë të sakt me ortophoto dhe GPS koordinata. Me 14 Tetor

2008 është paraqitur A.B. si palë përgjegjëse por nuk ka pretendur të drejtë pronësore mbi këtë pronë

4. Me vendimin grupor KPCC/D/R/207/2013 , Komisioni i Kërkesave Pronësore i Kosovës (më tej Komisioni) ka vendosur se bartësi i të drejtës pronësore në rastin konkret ka fituar të drejtën e përkohëshme të shfrytëzimit për të ndërtuar një strukturë të luajtshme dhe për këtë kërkesa duhet hidhet se është jashtë mandatit të Komisionit të përcaktuar me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
5. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës ankuese më 7 Nëntor 201. Më 10 Dhjetor, pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Pretendimi i palës ankuese:

6. Pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën e tij dhe ta ndryshojë vendimin e KKPK-së duke ia njohur të drejtat e saj mbi pronën e kërkuar. Në ankesë, ai theksoi se vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetim të gabuar dhe të mangët të fakteve, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Arsyetimi ligjor

7. Ankesa është e pa afatshme. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale parasheh si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës”*.
8. Palës ankuese iu dorëzua personalisht Vendimi i KKPK-së më 7 Nëntor 2013 prandaj afati kohor për të paraqitur ankesë përfundoi më me 9 Dhjetor 2013 pasi që dita e 30-ë ishte ditë jopune. Megjithatë, pala ankuese e paraqiti ankesën vetëm më 10 Dhjetor 2013 , pra një ditë pas afatit të fundit. Kjo do të thotë që ankesa është paraqitur jashtë afatit kohor të parashikuar me ligj.

9. Gjykata gjeti se dorëzimi ishte bërë personalisht në pajtim me nenin 110.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008). Pala ankuese nuk ka dhënë arsye për paraqitjen e vonshme të ankesës dhe Gjykata nuk mund të gjejë në shkresat e lëndës ndonjë arsye për vonesën.
10. Prandaj, ankesa u desh të hidhet poshtë si e papranueshme mbi baza procedurale të Ligjit të lartcekur. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtojë bazat e paraqitura në ankesë.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it